



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-02/3451/17
Data Datum Date	24-10-2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2439-17, për Zyrtarin e lartë z. Shpejtim Kryeziu – Drejtor i Auditimit të brendshëm në Ministrinë për komunitete dhe kthim, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2439/17, për Zyrtarin e lartë, z. Shpejtim Kryeziu, Drejtor i Auditimit të brendshëm në Ministrinë për Komunitete dhe kthim, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z. Shpejtim Kryeziu (DPK-03-02-2979-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Kryeziu është deklaruar se brenda afatit do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë, z. Kryeziu, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informacionet mbi ndryshimet në biznesin "Konto Group" Sh.p.k. (DPK/Dpki-03-02/3360/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z. Shpejtim Kryeziu tashmë ka hequr dorë nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /

